

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 10 SHKURT 2022

E nderuar kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë!

Fakti që sërish jemi sot në këtë sallë, në këtë seancë, ku po diskutojmë një nismë për ndryshimin e Kushtetutës, sado që të përpiqemi ta paraqesim si një procedurë rutinë, në thelb shpreh mungesë serioziteti dhe përgjegjshmërie në qasjen e Kuvendit ndaj ligjit themeltar të shtetit. Nga ana tjetër, objekti i nismës që synon zgjatjen e afatit të organeve të vetingut, më e pakta nxjerr në pah mungesën e vizionit që në nisje të inicimit të reformës në drejtësi, me të cilën, në fakt, shumëkush këtu është mburrur dhe vazhdon të mburret duke marrë merita të pamërituara. Reformat, si rregull, synojnë përmirësimin dhe përsosjen e fushës së veprimit ku adresohen, ndërkohë që me reformën tonë në drejtësi, më shumë se sa e pastruam sistemin, ne e kolapsuam atë. Më shumë nga sa i dhamë integritet dhe pavarësi, e komprometuam atë, aq sa edhe sot, gati pas shtatë vjetësh që prej nisjes së saj, askush nuk di të thotë se kur do të kemi realisht një sistem drejtësie të pavarur, funksional, me integritet dhe të besueshëm. Prandaj, teksa diskutojmë për projektligjin për ndryshime të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet të pranojmë se fatkeqësisht ajo është kthyer në një dokument te arnuar plot shtatë herë, si një praktikë e kësaj klase politike, e cila ka kthyer ligjin themeltar te vendit në më pak se në një ligj të zakonshëm, e të cilin edhe pse më 1998 e ka kaluar në referendum popullor, nuk e ka kryer më këtë proces, duke u hequr të drejtën qytetarëve që të shprehen për ndryshimet në Kushtetutën e tyre.

Pas ndryshimeve famëkeqe të vitit 2008, që shkatërruan kontrollin dhe balancën e pushteteve, duke u dhënë superpushtet kryetarëve të partive me ndryshimin e sistemit zgjedhor, duke fuqizuar ekzekutivin, duke dobësuar kontrollin parlamentar, e pa dyshim duke dobësuar rëndë institucionin e Presidentit, sot pas pasojave të rënda që solli ajo marrëveshje e errët e 2008-ës, pasojat e së cilës po i vuajmë çdo ditë, unë dhe çdo qytetar do të kishim pritur një reflektim, e padyshim një angazhim për të kryer një reformë të thellë kushtetuese, për të rivendosur kontrollin dhe balancat në Kushtetutën e vendit dhe jo më arnime të saj, ku si maxhoranca, ashtu edhe forcat e tjera politike, janë vënë në garë se kush e ndryshon më shpejt ligjin themeltar të vendit, një reformë kushtetuese që do të buronte nga ekspertët më të mirë konstitucionalistë dhe ekspertët të jurisprudencës, e jo më nga politikanë me interesa të ngushta partiake.

Ne, si Lëvizje Socialiste për Integrim, e kemi votuar ligjin e vetingut dhe kemi kontribuar për një votim konsensual të reformës në drejtësi, duke besuar ashtu si dhe 91 % e shqiptarëve, për arritjen e qëllimit të saj në dhënien e një drejtësie të shpejtë, eficiente e profesionale. Sot, mbas pesë vjetësh të implementimit të saj, ne duhet kemi një vlerësim të kësaj reforme dhe nuk duhet të kompleksohemi nga debati që ndihmon suksesin e saj për qytetarët. Ne duhet të pranojmë se sot besimi i qytetarëve ka rënë në mënyrë drastike, dhe sipas sondazheve llogaritet në 24 %. Kjo duhet të na bëjë të reflektojmë dhe të kemi guximin e përgjegjshmërinë për ta përmirësuar. Sot, si pasojë e procesit të ngadaltë të vetingut, kemi 37 mijë dosje që presin në Gjykatën e Lartë, që presin drejtësi. Sot gjykatat e apelit janë në kolaps dhe qytetarët nuk marrin drejtësinë e shpejtë dhe të drejtë, që prisnin para pesë vjetësh. Këto të vërteta duhet t'i themi në sy, por me vullnetin maksimal, që vlerësimin të

implementimit të reformës në drejtësi t'i japim mbështetjen maksimale, por dhe të rregullojmë gjërat që nuk kanë shkuar siç duhet. Të bëjmë një analizë pas pesë vjetësh të implementimit të reformës dhe të kemi kurajën për ta përmirësuar, që të arrijmë qëllimin për të cilin u iniciua kjo reformë: pikërisht për t'u shërbyer qytetarëve të thjeshtë, e ku të gjithë të jenë të barabartë para ligjit. Pa dyshim, duke marrë parasysh opinionin e Venecias dhe analizën e shumë ekspertëve, ne jemi për zgjatjen e mandatit të institucionit të vetingut, por nuk mund të biem dakord për zgjatjen e mandatit të personave që e ushtrojnë sot këtë detyrë, nuk biem dakord për integritetin profesional të tyre. Vetë ONM thotë në raportet e saj se ka pasur vendimmarrje me dy standarde dhe se besimi i publikut ka rënë në mënyrë drastike për këtë institucion. 24 % e vendimeve të KPK-së ankimohen në KPA, pra ne duhet të marrim përgjegjësitë që kur një afat kushtetues shkelet dhe besimi bie, të marrim vendime të forta, që të reflektojnë situatën në të cilën ndodhemi, për ta përmirësuar atë në dobi të interesit publik. Këta persona, të cilëve ne sot kërkohet t'u zgjatet mandati, kanë shkelur një afat kushtetues në ushtrimin e detyrës së tyre dhe s'mund t'i përjashtojmë nga përgjegjësia, sepse përveç faktorëve të tjerë, ka qenë edhe performanca e tyre ajo që ka lënë shumë për dëshiruar, duke thyer besimin e qytetarëve të ky proces.

Prandaj, ne nuk mund të vijmë sot këtu dhe të jemi koshientë për këtë fakt, që e pranojmë të gjithë brenda apo jashtë kësaj sale, dhe të mos kemi kurajën të pranojmë defektet, deformimet dhe pasojat që ato kanë sjellë për sistemin. Ndryshimet që propozohen nuk na garantojnë se e njëjta trupë vetingu, ata që nuk e bënë dot këtë punë për pesë vjet, do ta bëjnë në një afat që kërkohet të zgjatet, sepse deformimi nuk është kaq formal dhe nuk ka të bëjë me afatet formalisht, por është deformim konceptual e përmbajtësor, kur është fjala për rolin dhe standardet e institucioneve të vetingut. Unë personalisht kam qenë pjesë e Komisionit të Ligjeve dhe e Këshillit të Legjislacionit në të gjitha mbledhjet, që nga dita e parë, duke kontribuar profesionalisht dhe me dëshirën e mirë, që të mund t'i shërbenim deri në fund përmirësimit, sepse në interes të çdo qytetari prevalon mbështetja në sistemin gjyqësor të pavarur, të shpejtë, që u shërben njerëzve të thjeshtë të vendit, dhe ku kultura e pandëshkueshmërisë merr fund. Por edhe me propozimin që vjen sot, më duhet të jem e vërtetë dhe shumë e përgjegjshme me votën që jap sot. Mendoj se vota abstenim, që unë jap sot, është shumë e ndershme dhe e vërtetë në këtë proces kaq jetik për vendin, pa dyshim mbështetje për institucionin e vetingut, por jo për personat që e ushtrojnë sot këtë detyrë. Faleminderit!